REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3998 Prot. Maliq, më 26.06.2026

VENDIM
Nr.83, datë 25.06.2026
"PËR IDENTIFIKIMIN E PASURISË TË SHËNUAR X NË FSHATIN SELCË"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" , i ndryshuar, ndryshuar neni 8 pika 2, neni 9, pika nënpika 1.1, gërma "b" neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*", neni 64, "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë", gërma c*, ligjit nr. 107/2014 "Për *planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", neni 12, "*Përgjegjësitë e këshillit bashkiak",* Kërkesës nr.3332 prot, datë 29.05.2026 të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, Këshilli Bashkiak Maliq,

VENDOSI:

1. Të miratohet nga Këshilli Bashkiak kërkesa për tu pajisur me numër pasurie X sipas dokumentacionit teknik dhe hartës kadastrale, është konstatuar se një sipërfaqe prej 1691 m², aktualisht e përfshirë në pasurinë nr. 789 të regjistruar në llojin "pyll", përfaqëson në fakt rrugë ekzistuese që lidh fshatin Selcë me zonat përreth. Kjo rrugë kufizohet në veri me pasurinë nr. 53 dhe në jug me pasurinë nr. 536/17, e regjistruar si rrugë.

2. Për zbatim ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ